



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 12908 prot.

Shkodër, më 26.6 2025

VENDIM

Nr. 42, datë 25.06.2025

**“PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË SHKODËR, SË BASHKU ME
DOKUMENTACIONIN TEKNIKO-LIGJOR PËR AKORDIMIN E NDIHMËS
FINANCIARE PËR FAMILJEN E AGE KULLA DHE “MOTRAVE FRANÇESKANE
TË ZONJËS SË PAPËRLYER” BANESA E TË CILËS ËSHTË DËMTUAR
NGA ZJARRI”.**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 25.06.2025 me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në ligjin nr 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; ligjin nr. 45/2019, “Për Mbrojtjen Civile”; ligjin nr.68/2017, “Për financat vendore” i ndryshuar; VKM-në nr. 329, datë 16.05.2012, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”; VKM-në nr. 414, datë 08.07.2021 “ Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, i ndryshuar; VKB-në Nr 76, datë 19.12.2024 “ Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë së Shkodrës”, i ndryshuar, si dhe dokumentacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër;

VENDOSI:

- 1.Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për ndihmën e menjëhershme financiare të familjes së **Age Kulla** (1 anëtarë familje), në vlerën prej 20 000 (njëzet mijë) lekë (sipas certifikatës familjare të paraqitur), për dëmtimin e banesës së saj nga zjarri.
- 2.Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër, për familjen e **Age Kulla** në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore prej 171 569 (njëqind e shtatëdhjetë e një mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë dhe për dëmet në orendi prej 170 200 (njëqind e shtatëdhjetë mijë e dyqind) lekë, sipas preventivave të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e **Age Kulla**.
- 3.Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër, të **“Motrave Françeskane të Zonjës së Papërlyer”** në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore prej 323 128 (treqind e njëzet e tre mijë e njëqind e njëzet e tetë) lekë, sipas preventivave të Komisionit

të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, të **“Motrave Françeskane të Zonjës së Papërlyer”** .

4. Burimi i financimit të jetë fondi i emergjencave civile parashikuar në programin AB141

“ Siguria Publike dhe Mbrojtja Civile” në buxhetin e Bashkisë Shkodër për vitin 2025 të miratuar me VKB Nr. 76 datë 19.12.2024, “ Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë së Shkodrës”, i ndryshuar, në programin **AB141, Q2 O1 A4** “ Përballimi i ndihmave të menjëhershme për familjet me raste fatkeqësie”, në vlerën 20 000 (njëzet mijë) lekë. Ngarkohet administrata e Bashkisë Shkodër për likuidimin e ndihmës së menjëhershme.

5. Për familjen e Age Kulla dhe “Motrave Françeskane të Zonjës së Papërlyer”

kompensimi i dëmeve materiale ndërtimore dhe në orendi e pajisje do të bëhet sipas preventivave të vlerësimit hartuar nga grupi i verifikimit dhe vlerësimit, në zbatim të Ligjit 45/2019, “ Për Mbrojtjen Civile”, neni 41 , të VKM-së Nr.329 datë 16.05.2012 pika 3 dhe të VKM-së Nr. 414 datë 08.07.2021 pika 3.1/a, “ Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të Buxhetit të Shtetit për Mbrojtjen Civile”, sipas Relacionit bashkëngjitur, në masen 50 % të vlerës ndërtimore në shumën **247 348,5** (Dyqind e katërdhjetë e shtatë mijë e treqind e katërdhjetë e tetë, presje pesë.) lekë dhe në masen 50% të vlerës së orendive në shumën **85 100** (tetëdhjetë e pesë mijë e njëqind) lekë.

6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

7. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Miratuar me 35 vota

Vota Pro	35
Vota Kundër	0
Vota Abstenim	0
Zbardhur me datë	26.06.2025

SEKRETARE

Sabina Danaj



KRYETAR

Oltion LULI

